

FINANCA

Ditari Mujor | Maj 2024

Ministria e Financave prezanton Strategjinë e tretë të Menaxhimit të Financave Publike



Ministria e Financave prezantoi Strategjinë e tretë të Menaxhimit të Financave Publike, një dokument bazë i cili është punuar së bashku me ekspertët e Bashkimit Evropian dhe orienton politikën sa i përket reformave në menaxhimin e financave publike deri në vitin 2030. Në fjalën e tij, Ministri i Financave tha se forcimi dhe konsolidimi i mëtejshëm i financave publike është një nga kërkesat themelore edhe sa i përket rrugëtimit të vendit drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ministri theksoi faktin se Reforma e Menaxhimit të Financave Publike synon të sigurojë një sistem financiar publik që promovon transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe zhvillimin ekonomik. Duke iu referuar Strategjisë së re, Ministri Mete informoi se disa prej synimeve të saj janë: përmirësimi i mëtejshëm i politikave fiskale dhe makroekonomike; avancimi në planifikimin e integruar

strategjik dhe buxhetor, si edhe rritja e monitorimit dhe raportimit; rritja e mobilizimit të të ardhurave dhe përmirësimi i mëtejshëm i sistemeve për menaxhimin tatimor e doganor; forcimi i menaxhimit të zbatimit të buxhetit dhe implementimi i mëtejshëm i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit; avancimi i përputhshmërisë së sistemeve për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik në përputhje me praktikën e BE-së; integrimi i elementeve të ekonomisë së gjelbër, duke synuar procedurë dhe praktika që nxisin shpenzime drejt aktiviteteve të gjelbra. Në dekadën e fundit është shënuar progres i konsiderueshëm sa i përket reformave dhe masave të ndërmarra, gjatë zbatimit të dy strategjive të mëparshme të Menaxhimit të Financave Publike, ndërsa vendi ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme që kanë sjellë avancime domethënëse në procesin e integritimit evropian.

LEXO MË SHUMË



Performanca paraprake e të ardhurave dhe shpenzimeve për 4-mujorin 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për 4-mujorin e parë të vitit 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 4-mujore arritën në rreth 231.64 miliardë lekë ose 103.5% e planit të së njëjtës periudhë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mbledhën rreth 24.1 miliardë lekë më shumë, ose 11.6% më shumë se katër-mujori i vitit 2023. Të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (përfshirë edhe Kontributet e mbledhura nga DPT), arritën në 198.4 miliardë lekë, 18.5 miliardë ose 10.3% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, si dhe 4 miliardë ose 2.1% më shumë se plani 4-mujor për vitin 2024. Shpenzimet e përgjithshme publike për periudhën 4 mujore të vitit 2024, arritën në rreth 185.8 miliardë lekë me një realizim në masën 96.8 përqind të planit, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 shpenzimet e përgjithshme publike rezultojnë 7.4 përqind më të larta ose rreth 12.76 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet korentë për periudhën 4 mujore të vitit 2024 rezultuan në rreth 170.3 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 10 përqind më i lartë ose rreth 15.4 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet kapitale shënuan përshpejtim gjatë muajit prill dhe për periudhën 4 mujore të vitit 2024 kanë një realizim në masën rreth 15.5 miliardë lekë ose 96.4 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë.

LEXO MË SHUMË



Ministri i Financave merr pjesë në 25-vjetorin e Shoqatës Shqiptare të Bankave

Ministri i Financave, Ervin Mete, mori pjesë në eventin e organizuar me rastin e 25-vjetorit të Shoqatës Shqiptare të Bankave. Gjatë fjalës së tij, Ministri Mete tha se vendi është duke kaluar një moment pozitiv ekonomik dhe në kuadër shprehu bindjen se janë krijuar kushtet e favorshme për të rritur zgjerimin e aksesit në financë dhe rolin e sektorit bankar në zhvillimin e sektorit privat në vend. Sipas Ministrit, sektori bankar duhet të jetë edhe më aktiv sa i përket kreditimit dhe mbështetjes së mëtejshme të zhvillimit të ekonomisë, në një kohë që i duhet kushtuar një vëmendje e posaçme alokimit sa më eficient të fondeve drejt sektorëve më produktivë të ekonomisë, si dhe adaptimit të praktikave që kanë të bëjnë me financimin e gjelbër dhe të qëndrueshëm. Ministri informoi se së bashku me Bankën e Shqipërisë po punohet për një plan të përbashkët për rritjen e kreditimit, ndërsa theksoi nevojën e rritjes së përfshirjes financiare të popullsisë. Po ashtu, sipas Ministrit, një rëndësi të madhe në këtë drejtim ka dhe inovacioni, digjitalizimi dhe modernizimi i mëtejshëm i shërbimeve, që duhet të mbetet një prioritet i sektorit bankar, ndërsa para paralelisht i duhet kushtuar vëmendje edhe rritjes së vazhdueshme të sigurisë kibernetike.

LEXO MË SHUMË



Ministri Mete në takimin BE-Balkani Perëndimor "Një rajon, vizion i përbashkët", në Malin e Zi

Ministri i Financave, Ervin Mete, mori pjesë në takimin e Ministrave të Financave dhe atyre të Çështjeve Evropiane të Ballkanit Perëndimor "Një rajon, vizion i përbashkët", organizuar në Kotor të Malit të Zi. Në këtë takim, i cili u mbajt një ditë para Samimit të Liderëve Rajonalë, u diskutua për Planin e Rritjes dhe masat konkrete që synojnë përshpejtimin e konvergencës ekonomike të rajonit me Bashkimin Evropian. Ministri Mete, në fjalën e tij, u shpreh se procesi i miratimit të Planit të Rritjes brenda BE-së ka ecur me ritme të shpejta dhe se tani do të kontribuojë për të përshpejtuar reformat dhe rritur konvergencën mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. Ministri theksoi se Shqipëria është në një fazë të përparuar sa i përket anëtarësimit në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), ku rezultoi ndër vendet e para në rajon që ka dërguar tashmë para-aplikimin dhe po përgatitet të aplikojë zyrtarisht në muajin qershor. Gjithashtu, Ministri Mete vlerësoi mundësitë e ofruara nga BE-ja përmas Planit të Rritjes, ku qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor pritet të përfitojnë një sërë lehtësish dhe masash konkrete, përpara se të bëhen anëtare të BE-së.

LEXO MË SHUMË